

UDHËZUES PRAKTIK PËR METODOLOGJINË E KOSTIMIT (Shembuj të stilizuar bazuar në PRE-të)

Janez Šušteršič, Saša Jazbec, ekspertë të CEF



Shembulli 1:

Rritja e përfshirjes në arsimin parashkollor

VEÇORITË E MASËS

Masë komplekse që përfshinë investimin, pajisjet, subvencionet dhe punësim të ri dhe që kombinon burime të ndryshme të financimit

PIKAT KRYESORE TË METODOLOGJISË

Përkufizim sistematik i kategorive të kostos dhe burimeve të financimit
Kostot shtesë janë kostot krahasuar me vitin para reformës



Përshkrimi i masës

Parlamenti ka aprovuar ligjin për arsimin e obligueshëm parashkollor në moshën 5 vjeçare, me masat shoqëruese për të rritur regjistrimin nga 75 në 100% për tri vjet.

Aktivitetet, kostot dhe burimet e financimit

- Hapja e 100 qendrave parashkollore me kosto mesatare prej 250.000 EUR (80% investim i mbuluar nga kredia e BB-s; 20% pajisje)
- Punësimi i 300 mësimdhënësve shtesë me pagë mesatare bruto prej 600 EUR
- Subvencionimi për familjet e varfra i dhënë nga pushtetet lokale, i vlerësuar të mbulojë 20% të të gjithë fëmijëve me një kosto vjetore prej 960.000 EUR



Tabela e kostimit 10a (në 1000 EUR)

Viti	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Subvencione t dhe transferet	Shpenzimet kapitale	TOTALI:
X	360	1,000	192	4,000	5,552
X+1	1,080	2,000	480	8,000	11,560
X+2	2,160	2,000	960	8,000	13,120
TOTALI:	3,600	5,000	1,632	20,000	30,232

X: 20 qendra; X+1, X+2: 40 qendra

X: 50 mësimdhënës shtesë; X+1: 100; X+2: 150

X+1 dhe X+2: *kostot përfshijnë të gjithë mësimdhënësit e rinj të punësuar* (d.m.th, edhe ata të punësuar në X dhe X+1), sepse ata nuk ishin të punësuar në vitin para se të bëhej reforma (X-1), që është viti referues për këtë tabelë.

Subvencionet për familjet e varfra po ashtu kanë filluar të aplikohen gradualisht.

Tabela e financimit 10b (në 1000 EUR)

Viti	Buxheti qendror	Buxhetet lokale	Buxhet tjetër publik vendor	Fondet e IPA-s	Grantet tjera	Kreditë e projektit	Për tu përcaktuar	TOTALI:
X	1,360	192				4,000		5,552
X+1	3 080	480				8,000		11,560
X+2	4,160	960				8,000		13,120
TOT.	8,600	1,632				20,000		30,232

Pagat për mësime dhe përkrahje
Pajisjet për qendrat

Subvencionet
për fëmijët

Ndërtimi
i qendrave



Shembulli 2:

Zvogëlimi dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve publike

VEÇORITË E MASËS

Masë përfshinë kursimet për buxhetin

PIKAT KRYESORE TË METODOLOGJISË

Trajtimi i uljeve të shpenzimeve buxhetore

Vetëm kostot direkte duhet të përfshihen në tabela



Përshkrimi i masës

Qeveria do të ristrukturojë kompaninë publike të hekurudhës për të rritur efikasitetin.

Aktivitetet, kostot dhe burimet e financimit

- Viti X: zvogëlohet punësimi për 500 dhe paguhet borxhi ndaj punëtorëve. Kursimet e shpenzimeve për paga 2.4 mil EUR, pagesa e borxhit 5 mil. EUR
- Viti X+1: ristrukturimi i pronësisë: konvertimi i borxhit në aksione + blerja e aksionarëve të vegjël me 30 mil EUR.
- Vitet X+1 dhe X+2: ristrukturimi i biznesit me asistencë të huaj, kostoja totale e konsulentëve 0.5 mil EUR
- Të gjitha kostot do të mbulohen nga buxheti qendror



Tabela e kostimit 10a (në 1000 EUR)

Viti	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Subvencione t dhe transferet	Shpenzimet kapitale	TOTALI:
X	2,600	0	0	0	2,600
X+1	- 2,400	250	0	30,000	27,850
X+2	- 2,400	250	0	0	- 2,150
TOTALI:	- 2,200	500	0	30,000	28,300

Konsulentët dhe blerja e aksionarëve.

X: 5,000 për pagesën e borxhit *minus* 2,400 kursime në shpenzimet për paga.
X+1 dhe X+2: kursimet në shpenzimet për paga janë të përhershme (krahasuar me vitin para reformës) dhe janë *shënuar me shenjë negative*.

Mund të ketë **efekte sekondare**, për shembull shpenzimet e përfitimeve sociale/ të papunësisë për punëtorët e pushuar nga puna; fitimet e kompanisë së ristrukturuar. Tabela e kostimit përfshinë **vetëm kostot direkte të masës** dhe jo implikimet fiskale të përgjithshme.



Shembulli 3:

Aplikimi i arkave fiskale

VEÇORITË E MASËS
Masë që krijon të hyra

PIKAT KRYESORE TË METODOLOGJISË
Trajtimi i efekteve të të hyrave në tabelën e kostimit
Rasti pa ndonjë kosto shtesë



Përshkrimi i masës

Arkat fiskale do të instalohen nga të gjitha bizneset që janë të obliguara me ligj

Aktivitetet, kostot dhe burimet e financimit

- Viti X-1 (para përfshirjes së reformës në PRE): ligji për obligimin për arkat fiskale është aprovuar. Është zhvilluar dhe testuar softueri i nevojshëm
- Vitet X: bizneset blejnë dhe instalojnë arkat fiskale Qeveria ofron lehtësira tatimore prej 500 EUR secilit prej rreth 10,000 bizneseve që instalojnë arkën fiskale (5 mil EUR)
- Të hyrat e TVSH pritet të rriten për 75mil EUR, dhe një e treta e efektit të përgjithshëm (25 Mil EUR) priten që në vitin X.
- Nuk ka nevojë për punësime shtesë për zbatim.



Tabela e kostimit 10a (në 1000 EUR)

Viti	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Subvencione t dhe transferet	Shpenzimet kapitale	TOTALI:
X	0	0	0	0	0
X+1	0	0	0	0	0
X+2	0	0	0	0	0
TOTALI:	0	0	0	0	0

Fusnotë: të hyra të tjera të pritura nga kjo masë janë 20 mil EUR në vitin X dhe 75 mil EUR çdo vit në Vitet X+1 dhe X+2.

Kostoja e softuerit nuk është përfshirë pasi që ai është zhvilluar dhe paguar para përfshirjes së reformës në PRE (në Vitin X-1).

Nuk nevojitet punësim shtesë = zero kosto shtesë.

Efektet e pritura në të hyra janë *përfshirë vetëm në fusnotë*:

Viti X: 1/3 e të hyrave të pritura shtesë (25 mil EUR) *minus* uljes së pritur të të hyrave për shkak të lehtësirave tatimore (5 mil EUR). **Vitet X+1, X+2:** efekti i plotë (75 mil. EUR).



Mënyrë alternative e mbështetjes së aplikimit të arkave fiskale

Në vend të lehtësirave tatimore, secili biznes merr një subvencion prej 500 EUR (total 5 mil EUR)

Viti	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Subvencione t dhe transferet	Shpenzimet kapitale	TOTALI:
X	0	0	5	0	5
X+1	0	0	0	0	0
X+2	0	0	0	0	0
TOTALI:	0	0	5	0	5

Fusnotë: të hyra të tjera të pritura nga kjo masë janë 25 mil EUR në vitin X dhe 75 mil EUR në vit për Vitet X+1 dhe X+2.

Subvencionet për arkat fiskale janë përfshirë në tabelë. Efekti i pritur në të hyra në Vitin X tani është për 5 mil EUR më i lartë sepse nuk ka ulje për shkak të lehtësirave tatimore.



Shembulli 4:

Promovimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë

VEÇORITË E MASËS

Mat ku kostot (shpenzimet) varen nga financimi në dispozicion

PIKAT KRYESORE TË METODOLOGJISË

Planifikim realist i burimeve të financimit

Kategoria “të përcaktohet” në tabelën e financimit



Përshkrimi i masës

Qeveria do të subvencionoj prodhimin dhe konsumin e energjisë nga burimet e ripërtërishme (BRE)

Aktivitetet, kostot dhe burimet e financimit

- Viti X: zhvillimi i softuerit për mekanizmat e mbështetjes së orinetuar kah tregu (ankandet dhe premitë); 600.000 EUR për softuerin dhe 67.000 EUR për punësime shtesë.
- Vitet X+1 dhe X+2: disbursimi i premive për konsumin e energjisë nga BRE-të, vlerësohet në gjithsej 600.000 EUR.
- Vitet X deri X+2: subvendcionet për investim në kapacitetet e BRE-ve, financimi nga asistenca ndërkombëtare:
 - Fonde IPA tashme janë programuar në 5 mil EUR por kushtëzohen me funksionimin e mekanizmat bazuar në treg.
 - Kredia e BB-së e nënshkruar për 10 mil EUR BB ka treguar gatishmërinë për të negociuar për një kredi tjetër prej 5 mil EUR nëse kjo masë zbatohet mirë dhe ka rezultate të mira fillestare



Tabela e financimit 10b (në 1000 EUR)

Ne fillojmë me këtë tabelë sepse niveli i subvencioneve varet nga financimi në dispozicion.

Viti	Buxheti qendror	Buxhetet lokale	Buxhet tjetër publik vendor	Fondet e IPA-s	Grantet tjera	Kreditë e projektit	Për tu përcaktuar	TOTALI:
X	667			0		2.000	0	2,667
X+1	367			1,500		4,000	0	5,867
X+2	367			3,500		4,000	5,000	12,867
TOT.	1,401			5,000		10,000	5,000	21,401

X: 600 softuer, 67 paga

X+1, X+2: 300 premi, 67 paga

X: 0 sepse kushtëzohet me mekanizmat e tregut

X+1, X+2: Një pjesë më e vogël në X+1 si masë paraprake

Tashmë e nënshkruar, por planifikuar më pak në X si masë paraprake.

Mbetet për tu negociuar, nuk është siguruar ende financimi.



Tabela e kostimit 10a (në 1000 EUR)

Viti	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	TOTALI:
X	67	600	2 000	0	2 667
X+1	67	0	5 800	0	5 867
X+2	67	0	12 800	0	12 867
TOTALI:	201	600	20 600	0	21 401

X: Financimi i planifikuar nga kredia tashmë e nënshkruar e BB
X+1: Kredia e BB + fondet e para IPA + premitë nga buxheti.
X+2: Kredia e BB + IPA e mbetur + premitë + kredi e mundshme shtesë.

Nga pikëpamja e buxhetit, këto shpenzime janë subvencione, edhe pse marrësit do t'i përdorin subvencionet për investim.

Shembulli 5:

Programi i punësimit të të rinjve

VEÇORITË E MASËS

Masë e cilapërmirësohet dhe zgjerohet gjatë zbatimit

PIKAT KRYESORE TË METODOLOGJISË

Trajtimi i masave që zbatohen për më shumë se tri vjet

Trajtimi i masave që përshtaten gjatë zbatimit

Kostot shtesë janë kostot krahasuar me vitin para reformës



Përshkrimi i masës

Qeveria ka aprovuar një varg masash për të mbështetur punësimin e të rinjve, që duhet të zbatohen nga Shërbimi Publik i Punësimit (SHPP)

Aktivitetet, kostot dhe burimet e financimit

- Viti X: aranzhimet e zbatimit, punësimi i këshilltarëve shtesë në SHPP (40.000 EUR në vit) dhe trajnimi i tyre (30.000 EUR)
- Viti X+1: përfshirja e përfituesve në këtë masë, disbursimi i mbështetjes në shumën totale prej 2 mil EUR (20% buxheti, 80% IPA).
- Viti X+2: njëjtë si X+1, financimi rritet në 3 mil EUR.



Kostimi dhe tabelat e financimit 10a dhe 10b (në 1000 EUR)

Viti	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Subvencione t dhe transferet	Shpenzimet kapitale	TOTALI:
X	40	30	0	0	70
X+1	40	0	2 000	0	2 040
X+2	40	0	3 000	0	3 040
TOTALI:	120	30	5 000	0	5 150

Viti	Buxheti qendror	Buxhetet lokale	Buxhet tjetër publik vendor	Fondet e IPA-s	Grantet tjera	Kreditë e projektit	Për tu përcaktuar	TOTALI:
X	70			0				70
X+1	440			1 600				2 040
X+2	640			2 400				3 040
TOT.	1 150			4 000				5 150



Ndryshimet gjatë vitit të parë të zbatimit

Kishte vështirësi në zbatimin e masës:

- rekrutimi dhe trajnimi i SHPP-së ishte vonuar dhe do të përfundohet vetëm vitin tjetër, dhe gjysma e kostot është bartur për atë vit
- përfituesit e parë do të marrin mbështetjen vetëm në gjysmën e dytë të vitit tjetër
- financimi IPA rrjedhimisht nuk do të jetë në dispozicion vitin tjetër

Masat korrigjuese të miratuara nga qeveria:

- vitin tjetër: buxheti do të ofrojë financim të plotë për subvencionet, por shuma do të përgjysmohet krahasuar me planet fillestare
- vitet pasuese: masa do të vazhdohet për një vit Do të përfshihen më shumë përfitues krahasuar me planet fillestare, me një financim shtesë prej 300.000 EUR në vit që do të jepet nga buxheti
- Ndryshimet do të reflektohen në këtë masë në PRE-në e ardhshme



Tabela e ndryshuar e kostimit në PRE-në e ardhshme (në 1000 EUR)

Viti	Pagat	Mallrat dhe shërbimet	Subvencione t dhe transferet	Shpenzimet kapitale	TOTALI:
X	40	15	1,000	0	1,055
X+1	40	0	2,300	0	2,340
X+2	40	0	3,300	0	3,340
TOTALI:	120	15	6,600	0	6,735

Fusnotë: viti referues kundrejt të cilit llogariten kostot shtesë është X-2.

Tani Viti X është ai që ishte Viti X+1 në PRE-në paraprake.

Këto prapë janë **kosto shtesë** sepse ato *krahasohen me vitin para se të fillonte zbatimi i reformës (X-2)* dhe jo viti i fundit para kësaj PRE-je. Sqarojeni këtë në **një fusnotë** në tabelë.

Masa vazhdohet për një vit. Subvencionet rriten për financimin shtesë të ofruar tani nga buxheti, por shuma totale në Vitin X (Viti X+1 në PRE-në paraprake) përgjysmohet krahasuar me planet fillestare.



Tabela e ndryshuar e financimit në PRE-në e ardhshme (në 1000 EUR)

Viti	Buxheti qendror	Buxhetet lokale	Buxhet tjetër publik vendor	Fondet e IPA-s	Grantet tjera	Kreditë e projektit	Për tu përcaktuar	TOTALI:
X	1,055			0				1,055
X+1	740			1,600				2,340
X+2	940			2,400				3,340
TOT.	2 735			4 000				6,735

Tani Viti X është ai që ishte Viti X+1 në PRE-në paraprake

E rritur për subvencionet shtesë të dhëna nga buxheti.

Fondet IPA nuk do jenë në dispozicion në X siç ishte planifikuar fillimisht (Viti X+1 në PRE-në paraprake).



Si të shmangen reformat që vonohen për më shumë se tri vjet?

PLANIFIKONI PËR REFORMA NË FAZA (SEKUENCA) E JO REFORMA TË VAZHDUESHME

- Për shembull, në vend të masës së përgjithshme për politika të punësimit, e cila përmirësohet çdo vit me aktivitet të reja, zbatoni një sekuencë (fazë) të një mase më të vogël në PRE-të e njëpasnjëshme (p.sh., një vit për punësimin e të rinjve, një vit tjetër për pjesëmarrjen e grave, etj.).
- Kur të paraqitni një masë për herë të parë, planifikoni edhe vitin e fundit të zbatimit.

PËRFSHINI VETËM PJESËN E REFORMËS TË MASËS

- Për shembull, krijimi i një sistemi të mbështetjes për inovacion, NVM ose bujqësi, përfshirë zbatimin e tij të plotë, është reformë, ndërsa ofrimi i vazhdueshëm i mbështetjes në vitet pasuese nuk është më reformë (edhe nëse ende bëhen përshtatje)

ZËVENDËSONI REFORMAT QË NUK JANË DUKE FUNKSIONUAR

- Për shembull, kur reformat nuk zbatohen për shkak të kapacitetit, financimit ose për arsye të prioritizimit, ose kur ato duhet të përshtaten në mënyrë substanciale për të qenë efektive dhe të zbatueshme, zëvendësoni reformën e vjetër me një të re

